## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| Nr. Rendor [1] | Data e kërkesës[2] | Objekti i kërkesës[3] | Data e përgjigjes[4] | Përgjigje[5] | Mënyra e përfundimit të kërkesës[6] | Tarifa[7] |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 31.12.2021 | Kërkesë për informacion për çrregjistrimin e personit fizik | 04.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të bërë çregjistrimin e personit fizik, duhet të aplikoni nga llogaria e biznesit në e-albania shërbimin , "Aplikim për çregjistrimin e Personit Fizik" në linkun e mëposhtëm:https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13893Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.<br>Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 2 | 03.01.2022 | Kërkesë për | 04.01.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju | E plotë | Nuk ka |

[1] Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve
[2] Data e regjistrimit të kërkesës
[3] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[4] Data e kthimit të përgjigjes
[5] Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[6] Përgjigjja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar
[7] Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | informacion mbi shpalljen e martesës | | bëjmë me dije se hapi i parë i lidhjes së marteses, është shpallja e martesës. Procedura për të bërë shpalljen e martesës midis një shtetasi shqiptar dhe një shtetasi të huaj është si më poshtë vijon :Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar:<br>· certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile;`<br>dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese);<br>· dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj;<br>· fotokopje e dokumentit të identifikimit;<br>Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar.Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm:<br>· certifikatë lindje;<br>· certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martese”;<br>Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare.Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikate martese/ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | vendbanimin.Lidhur me pyetjen Tuaj, Ju bëjmë me dije se dokumenti i pranueshëm është fotokopje e dokumentit të identifikimit, pasaporta është mjet udhëtimi.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 3 | 03.01.2023 | Kërkesë për info mbi vendimin e komisionit të heqjes së lejes së drejtimit pas kryerjes së ankesës | 04.01.2023 | Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të përfituar cekun e bebes, femija duhet të jetë i rregjistruar në gjendjen civile në Shqipëri.Për të bërë regjistrimin e fëmijës, duhet:Akti i lindjes i mbajtur jashtë shtetit, i cili duhet të jetë i legalizuar, me vulë Apostile, i përkthyer në gjuhën shqipe, dhe i noterizuar.Nëse regjistrimin nuk do e kryejnë prindërit e fëmijës, ju duhet Prokurë e Posaçme për personin që do të kryejë regjistrimin dhe kopje të letërnjoftimeve elektronike të dy prindërve. Prokura leshohet nga nena e femijes, pasi edhe Ceku i Bebes leshohet ne emer te saj. Ne prokure duhet te theksohet se personi i autorizuar ka te drejte te beje:<br>Regjistrimin e femijes ne gjendjen civile,<br>Dorezimin e certifikatave te bonusit prane Drejtorise Rajonale te Sherbimit Social Shteteror dhe terheqjen e Cekut,<br>Dorezimin e Cekut prane Credins Bank dhe terheqjen e lekeve.<br>Në përfundim të regjistrimit të të porsalindurit, me qëllim përftimin e bonusit, nëpunësi i gjendjes civile pajis prindërit me 2 (dy) certifikata, përkatësisht: Certifikatë famjiljare dhe Certifikatë lindje e të porsalindurt, më shënimin “Për bonusin e lindjes”.Sëbashku me kopje ID të letërnjoftim elektronik paraqiteni pranë Drejtorisë Rajonale të Sherbimit Social Shtetëror të vendbanimit tuaj për tërhequr bonusin.Afati maksimal i regjistrimit, tërheqjes së cekut pranë Shërbimit Social Shtetëror, dhe dërgimi në Credins Bank, është 365 ditë nga data e lindjes së fëmijës.Certifikata me shënimin "Për bonusin e bebes", nuk gjenerohet online në e-albania.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 03.01.2023 | Kërkesë për informacion për shpalljen e martesës | 04.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se hapi i parë për lidhjen e martesës, është shpallja e martesës.- Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas shqiptar/e,Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa.<br>Dokumentacioni i nevojshem per shpalljen e marteses midis dy shtetasve shqiptare ne republiken e Shqiperise eshte:<br>certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martese”;<br>fotokopje e dokumentit të identifikimit dhe jo pasaportë ;<br>prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes;<br>Dhjetë ditë pas shpalljes partnerët pajisen me certifikatë lindje me shënimin "Për lidhje martese"Me këto certifikata,Me kartat e identitetit shqiptare dhe brenda afatit të vlefshmërisë,Me dy dëshmitarë me të cilët nuk keni lidhje të afërta familjare,Paraqiteni në gjendjen civile dhe bëni lidhjen e martesës.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 5 | 03.01.2023 | Kërkesë për informacion për çertifikatë nga akti martesës | 04.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për martesat e lidhura mbas vitit 2010, certifikata e martesës gjenerohet nga llogaria Juaj ne e-albania duke aplikuar shërbimin”Certifikatë nga akti i martesës” në linkun e mëposhtëm:<br>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11178Lidhur me konstatimin Tuaj, Ju bëjmë me dije se për të gjitha aktet e mbajtura jashtë shtetit, certifikatat nga akti nuk shfaqen në e-albania. Statusi pasqyrohet në certifikatën Tuaj personale.Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | | |
| 6 | 03.01.2023 | Kërkesë për info mbi përfundimin e prodhimit të pasaportës biometrike | 04.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se para se te aplikoni per Pasaporte biometrike të re, duhet të bëni denoncimin e humbjes se dokumenteve në Policinë e Shtetit duke aplikuar nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin "Deklarimi i humbjes së dokumenteve të ndryshme" ne linkun e meposhtem https://e-albania.noclick_al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14922<br>Nese pasaporta dhe karta e identitetit qe u kane humbur jane lëshuar para datës 31 Dhjetor 2011, nevojitet të plotësoni online në portalin e-Albania formularin e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duke klikuar linkun : https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13851<br>Klikoni opsionin “Përdor” dhe plotësoni formularin “Aplikim i formularit për lëshim për herë të parë ose rinovim të pasaportës”.<br>Ju nevojitet ngarkimi i fotografisë në standardin 4x5cm në formatin jpg, jpeg ose png. Ne rastin kur aplikimi është me procedurë të përshpejtuar (ose aplikim emergjent), nevojitet pervec ngarkimit te fotos, edhe ngarkimi i kopjes së kuponit të procedurës së përshpejtuar.<br>Pas shqyrtimit të aplikimit do të njoftoheni me sms dhe e-mail për miratimin ose jo të procedurës ligjore të kërkuar nga Policia. Pjesë e mesazhit të miratimit do të jetë edhe linku ku duhet të rezervoni datën dhe orën për t’u paraqitur fizikisht me qëllim vijimin e aplikimit.<br>Ditën që do të paraqiteni fizikisht për të vijuar me | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | aplikimin, duhet të keni me vete kuponin dhe Vertetimin e denoncimit te dokumenteve te humbura, që do të duhet ta dorëzoni pranë Zyrës së ALEAT.<br>Në rast se pasaporta aktuale është lëshuar pas datës 1 Janar 2012 duhet vetëm të rezervoni në këtë link https://rezervo.aleat.al/ për datën dhe orën e paraqitjes në sportelin ALEAT<br>Kujdes! Emaili me të cilin jeni i regjistruar në e-albania duhet të jetë aktiv sepse atje do Ju vijë miratimi i aplikimit Tuaj dhe linku për rezervim.Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | | |
| 7 | 04.01.2023 | Kërkesë për informacion çertifikatë nga akti lindjes | 04.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë certifikatë nga akti i lindjes, për aktet e regjistruara para vitit 2010, duhet të paraqiteni në zyrën e arkivave në Prefekturën e Qarkut ku është regjistruar akti i lindjes.Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 8 | 04.01.2023 | Kërkesë për informacion për vërtetimin | 04.01.2023 | PershendetjeFakti qe shfaqet ne formularin e pageses Bashkia Librazhd, nuk ndikon ne mberritjen e vertetimit. Aplikimi i eshte drejtuar drejtorise Tirana Veri, dhe kjo drejtori do t` Ju pajise me vertetimin. Vertetimi do permbaje informacion per rrethin e Tiranes, jo per qytetin e Librazhdit | E plotë | Nuk ka |
| 9 | 03.01.2022 | Kërkesë për informacion për rimbursimin e shpenzimeve | 04.01.2023 | Pershendetje!Bashkelidhur po Ju dergojme kartelen informative ku do te gjeni listen e dokumenteve per te perfituar rimbursimin e shpenzimeve .Keto dokumente do te dergohen me poste prane Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise<br>Afati ligjor i perfitimit eshte 1 vit nga dita qe ka nderruar jete i ndjeri. Pas ketij afati humbet e drejta e perfitimit | E plotë | Nuk ka |
| 10 | 30.12.2022 | Kërkesë për informacion për Platformën e | 04.01.2022 | Pershendetje! Dokumentet per te cilat keni aplikuar duhet tju mberrijne ne llogarine Tuaj ne e-albania ne seksionin Dokumentet e mia.Nese ka kaluar afati ligjor dhe dokumentet | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Bashkëqeverisjes | | nuk u kane mberritur, lutem dergoni ankesen tuaj ne portalin e bashkeqeverisjes ne linkun e meposhtem https://www.shqiperiaqeduam.al/#shtetiNeSHerbim<br>Pas 10 (dhjete) diteve nga momenti i plotesimit te ankeses Agjencia per Dialog dhe Bashkeqeverisje do T`ju ktheje pergjigje lidhur me problemin Tuaj | | |
| 11 | 29.12.2022 | Kërkesë për informacion për pushtetin Vendor | 04.01.2023 | Pershendetje Ne vijim te kerkeses Tuaj per informacion ju bejme me dije se Per problemet e parkimit, lutemi drejtohuni pushtetit vendor, pra Bashkise apo minibashkise te qendres Tuaj banuese | E plotë | Nuk ka |
| 12 | 29.12.2022 | Kërkesë për informacion për rregjistrim ndërkombëtar të markës tregëtare | 06.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin, Aplikim për regjistrim ndërkombetar të markës tregtare/disenjos industrial, në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13431<br>Nëpërmjet shërbimit elektronik "Aplikim për regjistrim ndërkombetar të markës tregtare/disenjos industriale" jepet mundësia e aplikimit online për qytetarët dhe subjektet për mbrojtjen e markës/disenjos industriale në disa vende të botës të zgjedhura nga ai dhe transferimin për:<br>-Aplikim për shtrirje të mëvonshme territoriale të markës tregtare<br>-Aplikim për shtrirje të mëvonshme territoriale të disenjos industrial<br>-Aplikim për regjistrim ndërkombëtar të markës tregtare<br>-Aplikim për regjistrim ndërkombëtar të disenjos industrial.Dokumentacioni që ngarkohet nga aplikanti:<br>- Formulari i përcaktuar nga Byroja Ndërkombëtare e WIPO-s;<br>- Mandati i pagesës së tarifës përkatëse për llogari të WIPO-s;<br>- Mandati i pagesës së tarifës përkatëse për ekzaminimin dhe përcjelljen e kërkesës nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale.<br>Mbi dokumentacionin gjeni opsionin për shkarkimin e faturës | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | së arkëtimit, për kryerjen e pagesës për shërbimin.<br>DPPI verifikon përputhshmërinë ligjore të kërkesës dhe përpilon aktin administrativ përkatës;<br>- Pas shqyrtimit dhe nëse kërkesa është në rregull, aplikanti pajiset me dokumentin përkatës në rrugë postare. Në të kundërt refuzohet kërkesa, duke njoftuar aplikuesin mbi arsyen e refuzimit nëpërmjet adresës e-mail.Nëse keni ende paqartësi, lutemi kontaktoni DPPI në adresën email mailinf@dppm.gov.al<br>Faleminderit | | |
| 13 | 05.01.2022 | Kërkesë për informacion për mbrojtjen nga shteti për grate e papuna | 06.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin, Aplikim për përfitimin nga programi i mbrojtjes së veçantë nga shteti, për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=15191Verifikimi automatik i përfituesve për përmbushjen e kritereve mbi moshën e fëmjëve dhe të ardhurat familjare bëhet çdo muaj. Rastet e daljes nga programi i përftitimit njoftohen elektronikisht në adresën e e-mail dhe në Hapesira Ime në e-Albania. Nëse pas daljes nga programi i përfitimit mendoni se i riplotësoni kriteret, mund të aplikoni sërish në portalin e-Albania. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 14 | 05.01.2022 | Kërkesë për informacion për logimin në ealbania | 06.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk keni aktive asnjë nga të dhënat e regjistrimit(adresë email dhe numër telefoni) për të gjeneruar një pasword të ri duhet të veproni si më poshtë:<br>Hapni një adresë të re email dhe dërgoni këto të dhëna në adresën:helpdesk@e-albania.al :<br><br>- foto të kartës ID | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | - emri i nënës<br>- emri i babait<br>- datëlindja e nënës<br>Specifikoni adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal.<br>Bëjmë me dije se regjistrimi në portal bëhet me të dhënat e kartës së identitetit. Jo me të pasaportës biometrike.<br>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.<br>Faleminderit! | | |
| 15 | 05.01.2022 | Kërkesë për informacion për çertifikatë që datojnë para 2010 | 07.01.2023 | Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se te gjitha certifikatat që datojnë akte (lindje, martese, vdekje, etj) para vitit 2010, nuk mundësohen në e-albania. Për këto certifikata procedohet si më poshtë:<br>Për qytetarët e Tiranës, certifikatat merren tek Bashkia Tiranë. Për rrethinat e Tiranës merren tek Prefektura Tiranë.<br>Për të gjitha bashkitë e komunat e tjera në territorin e Shqipërisë, certifikatat merren pranë Prefekturave të qarqeve respektive. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 16 | 05.01.2022 | Kërkesë për informacion për AVO | 08.01.2023 | Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të plotësuar një AV, ose e quajtur ndryshe “Akt Verifikimi” duhet të logoheni me të dhënat tuaja në e-Albania dhe më pas të kërkoni shërbimin që ju keni aplikuar së fundmi. Pra shërbim për të cilin do të plotësoni dokumentacionin me AV.<br>Pas kërkimit të shërbimit duhet të klikoni “Përdor” dhe më pas do të vazhdoni në fund të faqes ku do të gjeni një tabelë me këtë pamje:<br>Pasi të plotësoni të dhënat e mësipërme, klikoni butonin “Dërgo”.Ky dokument (AV) është kërkesa ose shkresa juaj që do ia drejtoni ASHK-së | E plotë | Nuk ka |
| 17 | 09.01.2023 | Kërkesë për | 09.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | infomacion e paqartë | | bëjmë me dije se kërkesa Juaj është e pa qartë. Për t`Ju orientuar drejt shërbimit kemi nevojë për më shumë detaje. Lutemi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose në online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 18 | 09.01.2023 | Kërkesë për informacion për pension pleqërie | 09.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se fillimisht aplikohet në e-albania për shërbimin "<br>Aplikim për pension pleqërie, suplementar pilot, suplementar lundrues i nëndetëseve apo suplementar për akademik", në linkun e mëposhtëm https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6156<br>e-Albania<br>Ky shërbim elektronik ju ofro<br>vijon: -Pleqërie, në zbatim të<br>Suplementar shtetëror pleqë<br>-Suplementar pleqërie si ush<br>...<br>e-albania.al<br>Pas aplikimit, dërgohen dokumentet me postë pranë Drejtorisë Lokale ose Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, duke vendosur mbi zarf numrin e referencës së aplikimit. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | E plotë | Nuk ka |
| 19 | 09.01.2023 | Kërkesë për informacion | 09.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se institucioni kompetent pë dhënien e | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mbi ASHK | | dokumentit që kërkoni është Agjencia Shtetërore e Kadastrës.Nëse keni një përgjigje zyrtare ku ASHK u referon se nuk mund t`Jua mundësojë këtë dokument, mund të depozitoni ankesën Tuaj në portalin e bashkëqeverisjes në linkun e mëposhtëm: https://www.shqiperiaqeduam.al/#shtetiNeSHerbim<br>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.<br>Faleminderit | | |
| 20 | 09.01.2023 | Kërkesë e për informacion për kordinatat e pronës | 09.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se koordinatat e pronës janë numrat e pasurisë së pronarëve me të cilët kufizohet prona Juaj. Këto të dhëna i gjeni në kartelën Tuaj të pasurisë dhe në hartën kadastrale.<br>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.<br>Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 21 | 09.01.2023 | Kërkesë për informacion për çertifiaktë të Trungut Familjar | 09.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Certifikatat e Trungut Familjar nuk mundësohen në e-albania. Për këto certifikata, procedohet si më poshtë:Për qytetarët e Tiranës, certifikatat merren tek Bashkia Tiranë.<br>Për rrethinat e Tiranës, merren tek Prefektura Tiranë.<br>Për të gjitha Bashkitë e Komunat e tjera në territorin e Shqipërisë, certifikatat merren pranë Prefekturave të Qarqeve respektive.<br>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E deleguar | Nuk ka |
| 22 | 08.01.2023 | Kërkesë për informacion për aplikimin në | 10.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se pasi bëni aplikimin në e-albania proces për të cilin ne Ju informojmë e asistojmë nëpërmjet kanaleve | E deleguar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ealbania | | tona të komunikimit, kompetenca dhe përgjegjësia i kalon institucionit të cilit i drejtohet aplikimi. Në rastin Tuaj Sigurimeve Shoqërore. Refuzimi duhet të ishte i shoqëruar me arsye. Pas aplikimit gjithmonë dërgohet dokumenti origjinal (vërtetimi i shkollës) me postë duke shkruar mbi zarf numrin e referencës së aplikimit.<br>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | | |
| 23 | 10.01.2023 | Kërkesë për informacion Aplikim për lëshim kopje kartele të pasurisë | 10.01.2023 | Pershendetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se duhet të aplikoni shërbimin "Aplikim për lëshim kopje kartele të pasurisë", në linkun e mëposhtëm https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9461<br>Dokumenti u dërgohet në seksionin " Dokumentet e mia " në llogarinë Tuaj në e-albania.Për çdo pyetje apo paqartesi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në të premte, në fashën orare 08.00 – 19.00 Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 24 | 10.01.2023 | Kërkesë për asistencë legalizim dokumentacioni | 10.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se duhet ta legalizoni sërish dokumentin, dhe brenda afatit ligjor të dokumentit duhet të regjistroni aktin.<br>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 25 | 10.01.2023 | Kërkesë për informacion anullim pagese te pageses se nje sherbimi | 10.01.2022 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk e keni kryer pagesën për shërbimin që keni aplikuar nuk e keni kryer pagesën e faturës, mund të ribëni aplikimin. Nëse e keni paguar, nuk ka mundësi anullimi.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 26 | 09.01.2023 | Kërkesë për info mbi procedurën e lidhjes së martesës | 10.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se duhet të bëni aplikim të ri. | E plotë | Nuk ka |
| 27 | 09.01.2023 | Ankesë për informacion për informacion për aktet lidhur me pronën të një shtetasi të huaj | 10.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se .duhet te aplikoni nepermjet nje noteri. Te gjithe shtetasit e huaj i drejtohen noterit per te regjistruar aktet dhe per te marre cdo dokument lidhur me pronen.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | E plotë | Nuk ka |
| 28 | 09.01.2023 | Kërkesë për informacion për kartelën shëndetrmacion për kartelën shëndetësore | 10.01.2022 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se : Duhet te paraqiteni tek qendra shendetesore ku eshte ndjekur qe nga femijeria. Atje gjendet dhe kartela e konsultori<br>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 29 | 09.01.2023 | Kërkesë për informacion për çertifikatat që datojnë para 2010 | 10.01.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se te gjitha certifikatat që datojnë akte (lindje, martese, vdekje, etj) para vitit 2010, nuk mundësohen në e-albania. Për këto certifikata procedohet si më poshtë: Për qytetarët e Tiranës, certifikatat merren tek Bashkia Tiranë. Për rrethinat e Tiranës merren tek Prefektura Tiranë. Për të gjitha bashkitë e komunat e tjera në territorin e Shqipërisë, certifikatat merren pranë Prefekturave të qarqeve respektive. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 30 | 09.01.2023 | Kërkesë për asistencë për vërtetim pensioni | 10.01.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se: Nese qytetarja eshte pjese e skemes se pensioneve ne shqiperi, duhet te aplikoje ne e-albania sherbimin " Vertetim Pensioni" https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=5033Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | E deleguar | Nuk ka |
| 31 | 10.01.2023 | Kërkesë për informacion për të regjistruar aktin e marrjen ne perdorim te tokes (AMTP) | 10.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije Fillimisht duhet të aplikoni për të regjistruar aktin e marrjen ne perdorim te tokes (AMTP).Ju mund të aplikoni për këtë shërbim online përmes platformës qeveritare e-Albania në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9444<br>Kërkoni shërbimin “Aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë me anë të ligjit me vendim të gjykatës apo të një akti administrativ” dhe aplikoni duke plotësuar formularin elektronik që shfaqet në platformë dhe duke ngarkuar dokumentacionin e nevojshëm për lëvrimin e shërbimit.<br>Në hapin e dytë duhet të shtoni edhe këto shërbime:<br>L1- Lëshim certifikate pronësie;<br>I5- Lëshim kopje kartele te pasurisë;<br>I4- Lëshim kopje te fragmentit te hartës kadastrale.<br>Dokumentacioni i nevojshëm për t`u ngarkuar është AMTP, certifikate familjare ne daten 01.08.1991. Plan rilevimi. AMTP dhe çdo document tjetër duhet të ngarkohet në të gjitha rubrikat e detyrueshme në hapin e tretë. Pamvaresisht se si i kane emertimet dokumentat qe duhen ngarkuar ne hapin e trete, do te ngarkoni dokumentat qe keni.Aplikimi për regjistrimin e AMTP dhe pajisjes me | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | certifikatë pronësie nuk penalizohet me gjobë, por kujdes! Në hapin e tretë, si datë lëshimi të dokumentit do të vendosni datën e kryerjes së aplikimit të mësipërm. Në fund klikoni opsionin “Dërgo”.Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën ose kryeni pagesën online përmes portalit e-Albania me një kartë debiti ose kredit.Nëse pagesa kryhet në bankë ose postë, duhet që t`i riktheheni edhe njëherë aplikimit për të ngarkuar mandatpagesën.Ngarkimi i mandatpagesës:Duhet të logoheni në e-Albania dhe të kërkoni shërbimin e aplikuar. Nuk do të kryeni aplikim të ri por do të shkoni në fund të formularit, në seksionin “Dërgo mandat-pagesën e një aplikimi të kryer”. Plotësoni të gjitha fushat, numrin e referencës së aplikimit e gjeni edhe tek “Mesazhet e mia”, ngarkoni faturën dhe më pas klikoni “DërgoPër cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 | | |
| 32 | 11.01.2023 | Kërkesë për informacion për çertifikatë nga akti lindjes | 11.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjme me dije se për të marrë certifikatë nga akti i lindjes, për aktet e lindjes të regjistruara pas vitit 2010, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin “ Certifikatë nga akti i lindjes” në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11176Ndërsa për aktet e regjistruara para vitit 2010, duhet të paraqiteni në zyrën e arkivave në Prefekturën e Qarkut ku është regjistruar akti i lindjes.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 33 | 11.01.2023 | Kërkesë për asistencë për problem në llogarinë | 11.01 .2023 | Përshëndetje Në vijim të kerkeses Tuaj për informacion ju bëjme me dije se  Lutemi kontaktoni adresen zyrtare te institucionit qe i keni drejtuar aplikimin ne adresen E-mail:  mailinf@dppm.gov.aldhe depozitoni ankesen tuaj per | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ealbania | | shkelje te afateve ligjore te levrimit te sherbimit ne portalin e bashkeqeverisjeshttps://www.shqiperiaqeduam.al/#shtetiNeSHerbimFaleminderit | | |
| 34 | 12.01.2023 | Kërkesë për info mbi pajisjen me certificate trungu | 12.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Certifikatat e Trungut Familjar nuk mundësohen në e-albania. Për këto certifikata, procedohet si më poshtë:Për qytetaret e Tiranës, certifikatat merren tek Bashkia Tiranë.Për rrethinat e Tiranës, merren tek Prefektura Tiranë.Për të gjitha Bashkitë e Komunat e tjera në territorin e Shqipërisë, certifikatat e trungut merren pranë Prefekturave të Qarqeve respektive. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 35 | 12.01.2023 | Kërkesë për informacion apostilimin e dokumentacioneve | 12.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se të gjithë dokumentet e lëshuara nga një shtet i huaj, që të kenë fuqi ligjore në një shtet tjetër, duhet të jenë të legalizuara e të apostiluara.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në kanalin tonë informativ online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00., ose në numrin e telefonit pa pagesë 0800 0118.Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 36 | 12.01.2023 | Kërkesë për info Aplikim për lëshim vërtetimesh (negativ/ pozitiv), | 12.01.2023 | PërshëndetjeNë vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për Tù pajisur me dokumentin që kërkoni, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin, Aplikim për lëshim vërtetimesh (negativ/poziti), në linkun e mëposhtëm:https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9464Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 37 | 11.01.2023 | Kërkesë për informacion mbi nje njoftim automatik nga Policia e Shtetit | 12.01.2023 | I nderuar qytetar,Nese Ju nuk keni aplikuar per pasaporte, mos e merrni ne konsiderate kete njoftim automatik te sistemit te policise se shtetit.Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 38 | 12.01.2023 | Kërkesë për info apostilimi i dokumenteve për aplikim për vizë | 12.01.2023 | Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion ju bëjme me dije se, nuk është i nevojshëm apostilimi i dokumenteve kur aplikoni për vizë.Për çdo pyetje dhe paqartësi mund të na kontaktoni përsëri! Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 39 | 12.01.2023 | Kërkesë për informacion për certifiakta qe datojne para 2010 | 12.01.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se te gjitha certifikatat që datojnë akte (lindje, martese, vdekje, etj) para vitit 2010, nuk mundësohen në e-albania. Për këto certifikata procedohet si më poshtë: Për të gjitha bashkitë e komunat e tjera në territorin e Shqipërisë, certifikatat merren pranë Prefekturave të qarqeve respektive. Dmth në Prefekturë duhet ta merni.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 40 | 13.01.2023 | Kërkesë për informacion për certifikata te trungut familjar | 13.01.2023 | PërshëndetjeNë vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se certifikata e vitit 2008 konsiderohet si certifikatë trungu familjar. Certifikatat e Trungut Familjar nuk mundesohen ne e-albania. Per keto certifikata, procedohet si me poshte:Per qytetaret e Tiranes, certifikatat merren tek Bashkia Tirane.Per rrethinat e Tiranes merren tek Prefektura Tirane.Per te gjitha Bashkite e Komunat e tjera ne territorin e Shqiperise, certifikatat merren prane Prefekturave te Qarqeve respektive. Në rastin Tuaj, certifikatën do ta merrni pranë Prefekturës së Qarkut Elbasan.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 41 | 11.01.2022 | Kërkesë për | 11.01.2022 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | informacion për logimin ealbania | | bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk keni aktive asnjë nga të dhënat e regjistrimit(adresë email dhe numër telefoni) për të gjeneruar një pasword të ri duhet të veproni si më poshtë: Hapni një adresë të re email, dhe dërgoni këto të dhëna në adresën:helpdesk@e-albania.al :<br>- foto të kartës ID<br>- emri i nënës<br>- emri i babait<br>- datëlindja e nënës<br>Specifikoni adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal.Bëjmë me dije se regjistrimi në portal bëhet vetëm njëherë. Nuk ekziston mundësia të kancelohet regjistrimi i mëparshëm për t`u regjistruar.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | | |
| 42 | 13.01.2023 | Kërkesë për informacion numrin e references se aplikimit | 13.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se numrin e referencës së aplikimit që u shkarkohet tek rubrika " Mesazhet e mia" pas dërgoni aplikimin, nuk e rikuperoni dot nëse e keni fshirë. Tek mandat pagesa ju mbetet vetëm numri dhe data e kërkesës. E njëjta gjë vlen edhe pë rastet kur u dërgohet dokumenti për të cilin keni aplikuar në opsionin "Dokumentet e mia", nëse e fshini, duhet të riaplikoni sërish duke e paguar sërish tarifën e shërbimit.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 43 | 13.01.2023 | Kërkesë për infrmacion për pension invadiliteti | 13.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se kategoria që trajtohet me pension invaliditeti, familjar, apo ndihmë ekonomike, e marrin shpërblimin aty ku marrin pensionin. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 44 | 12.01.2023 | Kërkesë për informacion për certtifikatë nga akti martesës | 13.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Certifikate nga akti i marteses, per aktet e lidhura jashte shtetit, nuk mundesohen ne e-albania. Duhet te paraqitet ne prfekturen e qarkut Durres.<br>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | E plotë | Nuk ka |
| 45 | 15.01.2023 | Kërkesë për info shpalljen e martesës | 16.01.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se kjo procedurë nuk realizohet online. Po ju dërgojmë prooceduren per shpalljen emarteses me shtetas te huaj-Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, Nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar:1. certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile;2. dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese);3. dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj;4. fotokopje e dokumentit të identifikimit;Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar.<br>Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm:1. certifikatë lindje;<br>2. certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martese”;<br>Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare.Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikate martese/ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | | |
| 46 | 13.01.2023 | Kërkesë për informacion Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë) | 16.01.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se per cdo informacion lidhur me pronat lutemi aplikoni sherbimin informazion zyrtar i pasurise Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë), ne linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477Procedura duhet të shoqërohet me një kërkesë me shkrim nga ana Juaj në format PDF, të cilën do ta ngarkoni në hapin e tretë të aplikimit. Agjencia Shtetërore e Kadastrës do T`Ju pajisë me informacionin që kërkoniPër cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | E plotë | Nuk ka |
| 47 | 14.01.2023 | Kërkesë për asistencë për rregjistrimin në llogarinë ealbania | 16.01.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se: Regjistrimi në portalin qeveritar e-Albania mund të kryhet si për shtetasit shqiptarë, ashtu dhe për shtetasit e huaj të pajisur me leje qëndrimi në Shqipëri. Shtetasit shqiptarë mund të regjistrohen nëpërmjet Numrit Personal të Identifikimit, të cilin mund ta gjejnë në kartën e tyre të identitetit ose në pasaportë. Ndërsa shtetasit e huaj mund të regjistrohen nëpërmjet Numrit të Identifikimit, me të | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | cilin janë pajisur në momentin e marrjes së lejes së qëndrimit. Pasi të jetë hapur portali www.e-albania.al<br>e-Albania<br>E-albania është portali qeveritar ku shërbimet publike që gjenden në zyrat dhe sportelet fizike të institucioneve ofrohen në mënyrë elektronike falë Platformës Qeveritare të Ndërveprimit që ndërlidh sistemet e institucioneve me njeri-tjetrin.<br>e-albania.al<br>duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm:<br>Klikoni "Regjistrohu/Register"<br>Plotësoni të gjitha të dhënat e specifikuara në formularin e regjistrimit<br>Kodi i përdoruesit (NID: Numri personal i identifikimit) / User Personal Identification Number (NID): Është numri personal i identifikimit.<br>Data e skadimit të kartës së identitetit / Identification document expiry date: Vendosni datën e skadimit të kartës së identitetit në formatin datë.muaj.vit.<br>Fjalëkalimi / Password: Sigurohuni që fjalëkalimi të jetë 8 deri në 12 karaktere i gjatë dhe nuk duhet të fillojë ose mbarojë me hapësira.<br>E-mail: Në këtë adresë do të vijë linku i aktivizimit të llogarisë dhe të gjitha njoftimet që kanë te bëjnë me aplikimet tuaja.<br>Numri i celularit / Mobile phone number: Sigurohuni që të vendoset në formatin e duhur. Për numrat shqiptarë formati është '06xxxxxxxx' ndersa për numrat jashtë Shqipërisë, formati i saktë është '0044/0039/0032xxxxxxxx', në varësi të shtetit ku jetoni.<br>Të dhënat personale (Emri / Name, Mbiemri / Surname, Atësia / Father Name, Mëmësia / Mother Name, Datëlindja / Birthdate): Duhet të bëhet kujdes që të gjitha të dhënat të jenë të sakta dhe të përputhen më të dhënat e Regjistrit të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Gjendjes Civile.<br>* Kujdes me të dhënat që mund të kenë "ë", ose "ç". Nëse edhe pas verifikimit të të dhënave tuaja në Gjendjen Civle do të keni vështirësi me regjistrimin kontaktoni ne adresen : helpdesk@e-albania.<br>Plotësoni kodin katër shifror të dërguar me SMS në numrin tuaj të telefonit dhe klikoni në linkun e aktivizimit në adresën tuaj e-mail për aktivizimin e llogarisë tuaj.<br>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | | |
| 48 | 16.01.2023 | Kërkesë për informacion për lëvizjen në zonën shengen | 16.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se rregullat për lëvizjen në zonën schengen, nuk kanë lidhje as me martesën dhe as me ndryshimin apo jo të gjeneraliteteve, pasi ID Juaj mbetet e njëjta.<br>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.<br>Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 49 | 16.01.2023 | Kërkesë për informacion për të ardhurat e barrëlindjes | 16.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse ju e keni filluar marrjen e pagesës së raporteve të lindjes dhe kompania që bënte aplikimin pë raportet e barrëlindjes ka falimentuar, për muajt në vijim do aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin, Kërkesë për shpërblim lindje dhe grant për fëmijë të lindur për persona të vetpunësuar, në linkun e mëposhtëm https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=10060<br>e-Albania<br>E-albania është portali qeveritar ku shërbimet publike | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ofrohen në mënyrë elektronike falë Platformës Qeveritare të Ndërveprimit që ndërlidh njeri-tjetrin.<br>e-albania.al<br>Pas aplikimit, formularin origjinal të raportit e dërgoni me postë pranë Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore duke vendosur mbi zarf numrin e referencës së aplikimit.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 50 | 16.01.2023 | Kërkesë për informacion mbi mbiemrin e deshmitareve ne lidhjen e marteses | 16.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nuk ka rëndësi mbiemri i dëshmitarëve, por lidhja që keni me ta. Nuk duhet të keni lidhje të afërta familjare.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 51 | 16.01.2023 | Kërkesë për informacion për rregjistrimin në ealbania | 16.01.2023 | PërshëndetjeNë vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë të dhënat e sakta duhet të dërgoni email në adresënhelpdesk@e-albania.al.Përshkruani problemin Tuaj, dhe bashkëlidhni në email këto të dhëna,Foto të kartës së identitetit<br>Emrin e nënës<br>Emrin e babait<br>Vendlindjen dhe datlindjen e nënës<br>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.<br>Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 52 | 16.01.2023 | Kërkesë për info prokurë e posacme. | 16.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për T`u pajisur me prokurë, nga llogaria Juaj në e-albania duhet të aplikoni shërbimin " Aplikim për prokurë të posaçme" në linkun e mëposhtëm:https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code= | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 9783<br>e-Albania<br>E-albania është portali qeveritar ku shërbimet publike o<br>ofrohen në mënyrë elektronike falë Platformës Qeverita<br>njeri-tjetrin.<br>e-albania.al<br>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 53 | 16.01.2023 | Kërkesë për informacion për shpallje martese | 16.01.2023 | Përshëndetje<br>Në vijim të kerkeses Tuaj per informacion ju bejme me dije se Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj,Nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar:1. certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile;2. dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese);3. dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj;4. fotokopje e dokumentit të identifikimit;Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar.Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm:1. certifikatë lindje;2. certifikatë lindje me shënimin "për lidhje martese";Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare.Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikate martese/ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | | |
| 54 | 17.01.2023 | Kërkesë për informacion për listën e notave të fëmijëve | 17.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se pët të marrë listën e notave të fëmijëve Tuaj, mjafton të kërkoni në google smip.al, të regjistroheni si përdorues i faqes dhe më pas të logoheni me të dhënat Tuaja në e-albania.Klikoni linkun e mëposhtëm dhe bëni regjistrimin në portal.SMIP<br>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 55 | 16.01.2023 | Kërkesë për informacion për logim ealbania | 18.01.2023 | Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk keni aktive asnjë nga të dhënat e regjistrimit(adresë email dhe numër telefoni) për të gjeneruar një pasword të ri duhet të veproni si më poshtë:<br>Hapni një adresë të re email, dhe dërgoni këto të dhëna në adresën:<br>helpdesk@e-albania.al :<br>foto të kartës ID<br>- emri i nënës<br>- emri i babait<br>- datëlindja e nënës<br>Specifikoni adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 56 | 16.01.2022 | Kërkesë për informacion për QKB | 17.01.2023 | Drejtohuni QKB ne adresen email info.qkb@qkb.gov.al | E deleguar | Nuk ka |
| 57 | 17.01.2023 | Kërkesë për info kërkesë për leje qëndrimi | 18.01.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se **Kërkesë për leje qëndrimi / Residence permit**https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9628Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | E deleguar | Nuk ka |
| 58 | 17.01.2023 | Kërkesë për informacion për bonbusin e bebes | 17.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se afati ligjor i tërheqjes së bonusit të lindjes, është 1 vit nga data e lindjes së fëmijës. Pas këtij afati e drejta e përfitimit humbet.Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | E plotë | Nuk ka |
| 59 | 19.01.2023 | Kërkesë për informacion për certifikatën e Trungut Familjar | 19.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Certifikatat e Trungut Familjar nuk mundësohen në e-albania. Për këto certifikata, procedohet si më poshtë:Për qytetaret e Tiranës, certifikatat merren tek Bashkia Tiranë.Për rrethinat e Tiranës merren tek Prefektura Tiranë.Për të gjitha Bashkitë e Komunat e tjera në territorin e Shqiperisë, certifikatat merren pranë Prefekturave të Qarqeve respektive.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 60 | 18.01.2023 | Kërkesë për informacion për vërtetim të diplomës në proçes njohje | 19.01.2023 | Pershendetje Ne vijim te kerkeses Tuaj per informacion ju bëjme me dije se **Vërtetim që diploma është në proçes njohjeje** https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14162Ky eshte sherbimi qe duhet te aplikoni | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 61 | 18.01.2023 | **Kërkesë për informacion për** Aplikim për shtesa në kategoritë e licencës individuale në studim e projektim dhe/ose në mbikëqyrje e kolaudim | 19.01.2023 | Pershendetje Ne vijim te kerkeses Tuaj per informacion ju bejme me dije se duhet Te aplikoni sherbimin si pajisje per here te pare, dhe te bashkelidhini nje kerkese me shkrim ku te shpjegoni situaten.Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 62 | 19.01.2023 | Kërkesë për info në lidhje me e fitimit të shtetësisë dhe pasaportës shqiptare | 19.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Ju keni të drejtën e fitimit të shtetësisë dhe pasaportës shqiptare si pasardhës i lindur nga prindër me shtetësi shqiptare. Në kërkesën Tuaj për informacion nuk keni referuar vitin e lindjes.<br>Hapi i parë është regjistrimi Juaj në gjendjen civile ku janë të regjistruar dhe prindërit Tuaj në Shqipëri. Dokumenti ligjor për regjistrimin Tuaj në regjistrin kombëtar të popullsisë në Shqipëri, është akti i lindjes në Amerikë me vulë apostile.<br>Duke qenë se na duhen më shumë të dhëna, lutem na kontaktoni në online chat Adisa, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 63 | 20.01.2023 | Kërkesë për informacion shpallja e martesës | 20.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se fillimisht duhet të kryeni shpalljen e martesës. Procedura për të bërë **shpalljen e martesës mes dy shtetasve shqiptarë në Republikën e Shqipërisë** është si më poshtë vijon Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa.Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë:certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | martese";fotokopje e dokumentit të identifikimit; Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, secili nga bashkëshortët e ardhshëm pajiset me dokumentin certifikatë lindje për lidhje martese. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy dëshmitarë. **Lidhur me pyetjen tuaj** , Ju bëjmë me dije se partneri nuk mund të veprojë vetëm. Mund të vepronte vtëm nëse Ju do ta kishit pajisur me prokurë të posaçme që të bënte shpalljen e martesës edhe në emrin Tuaj. Nëse do qëndoni 12 ditë në Shqipëri e mbyllni pa problem procedurën e shpalljes dhe të lidhjes së martesës.Për cdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanalin informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në te premte ne fashen orare 08.00 – 19.00 | | |
| 64 | 20.01.2023 | Kërkesë për informacion mbi lidhjen e martesës | 20.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se dokumentet e nevojshëm për lidhjen e martesës janë:Certifikatë me shënimin "për lidhje martese";Fotokopje e dokumentit tëidentifikimit.Theksojmë se karta e identitetit shqiptare duhet të jetë brenda afatit të vlefshmërisë.Për cdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanalin informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në të premte në fashën orare 08.00 – 19.0 | E plotë | Nuk ka |
| 65 | 19.01.2023 | Kërkesë për info në lidhje me aplikimin që duhet të kryhet për tregti online | 20.01.2023 | Pershendetje.Ne vijim te kerkeses Tuaj per informacion ju bejme me dije se ;Aplikim për vërtetim deklarimi për punësim për shtetas të BE-së, Zonës Shengen, të SHBA-së, Ballkanit Perëndimor https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12547Faleminderit | E deleguar | Nuk ka |
| 66 | 20.01.2023 | Kërkesë për informacion për lidhjen e martesës | 20.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se hapi i parë për lidhjen e martesës, është shpallja e martesës<br>-Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj,Nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar: . certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile;. dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese);. dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj;. fotokopje e dokumentit të identifikimit;Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar.Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm:1. certifikatë lindje;<br>2. certifikatë lindje me shënimin "për lidhje martese";<br>Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare.Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikate martese/ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | | |
| 67 | 20.01.2023 | Kërkesë për informacion për mandate pagesën | 20.01.2023 | Pershendetje Ne vijim te kerkeses Tuaj për informacion ju bëjme me dije se Nese nuk u eshte shkarkuar gjate aplikimit, nese nuk u eshte dhene mundesia ta paguani online, lutemi paraqituni tek sekretaria e MIE per te terhequr mandat pagesen qe me pas ta paguani ne banke e ta ngarkoni ne | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | aplikimFaleminderit | | |
| 68 | 20.01.2023 | Kërkesë për informacion për lidhjen e martesës | 21.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se hapi i parë për lidhjen e martesës, është shpallja e martesës.-Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj,Nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar:1. certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile;2. dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese);3. dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj;4. fotokopje e dokumentit të identifikimit;Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar.Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm:1. certifikatë lindje;2. certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martese”;Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare.Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikate martese/ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 69 | 20.01.2023 | Kërkesë për | 21.01.2023 | Pershendetje Ne vijim te kerkeses Tuaj per informacion ju | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | info në lidhje me rastet duplicate të ealbania | | bejme me dije se Per kthim pergjigjet dhe arsyet e refuzimit te aplikimit, drejtohuni institucionit qe i keni derguar aplikimin. Adisa Ju informon dhe asiston vetem proceduren e aplikimit.Faleminderit | | |
| 70 | 19.01.2023 | Kërkesë për informacion për certificate residence për individët | 20.01.2023 | Pershendetje Ne vijim te Kerkeses Tuaj per informacion ju bejme me dije se **Aplikim për certifikatë rezidence për individët**https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13940Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 71 | 24.01.2023 | Kërkesë për informacion lejen e legalizimit | 24.01.2023 | Në vijim të kërkesës tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se, fillimisht duhet të aplikoni për të regjistruar lejen e legalizmit.Ju mund të aplikoni për këtë shërbim online përmes platformës qeveritare e-Albania në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9444Kërkoni shërbimin “Aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë me anë të ligjit me vendim të gjykatës apo të një akti administrativ” dhe aplikoni duke plotësuar formularin elektronik që shfaqet në platformë dhe duke ngarkuar dokumentacionin e nevojshëm për lëvrimin e shërbimit.<br>Në hapin e dytë duhet të shtoni edhe këto shërbime:<br>L1- Lëshim certifikate pronësie;<br>I5- Lëshim kopje kartele te pasurisë;<br>I4- Lëshim kopje te fragmentit te hartës kadastrale.<br>Dokumentacioni i nevojshëm për t`u ngarkuar është shkresa përcjellëse, ose në mungesë të saj leja e legalizimit. Leja e legalizimit ose çdo document tjetër duhet të ngarkohet në të gjitha rubrikat e detyrueshme në hapin e tretë.<br>Aplikimi për regjistrimin e lejes së legalizimit dhe pajisjes me certifikatë pronësie nuk penalizohet me gjobë, por kujdes! Në hapin e tretë, si datë lëshimi të dokumentit do të vendosni datën e kryerjes së aplikimit të mësipërm. Në fund klikoni opsionin “Dërgo”. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën ose kryeni pagesën online përmes portalit e-Albania me një kartë debiti ose kredit.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit | | |
| 72 | 24.01.2023 | Kërkesë për informacion Deklarimi i humbjes së dokumenteve të ndryshme | 24.01.2023 | Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të denoncuar dokumentet e humbura, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin:<br>Deklarimi i humbjes së dokumenteve të ndryshme<br>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14922<br>Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular. Pas përgatitjes së vërtetimit të humbjes, do të njoftoheni me e-mail dhe te seksioni "Dokumentet e mia" në e-Albania brenda 3(tre) ditëve..Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 73 | 25.01.2023 | Kërkesë për informacion ër shpalljen e martesës | 25.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se fillimisht duhet të kryeni shpalljen e martesës. Procedura për të bërë shpalljen e martesës mes dy shtetasve shqiptarë në Republikën e Shqipërisë është si më poshtë vijon :Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa.<br>Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë:<br>prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes;<br>certifikatë lindje, me shënimin "për shpallje martese"; | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | fotokopje e dokumentit të identifikimit; Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, secili nga bashkëshortët e ardhshëm pajiset me dokumentin certifikatë lindje për lidhje martese. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy dëshmitarë.Lidhur me pyetjen tuaj , Ju bëjmë me dije se shpallja e martesës bëhet në të dyja gjendjet civile duke qenë prezent të dy vetëm pranë gjendjes civile. Nga 1 Maj 2022 nuk ka më ofrim shërbimesh në sportelet fizike Adisa.Për cdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanalin informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në te premte ne fashen orare 08.00 – 19.00.Faleminderit! | | |
| 74 | 25.01.2023 | Kërkesë për informacion për kartë identiteti | 25.01.2023 | Përshëndetje, Në vijim te kerkeses Tuaj per informacion ju bejme me dije se duhet ta beni aplikimin per karte identiteti nga fillimi.Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 75 | 25.01.2023 | Kërkesë për info certfikaten e marteses | 25.01.2023 | Përshëndetje Në vijim të Kërkesës Tuaj për informacion ju bëjme me dije se Ne momentin qe merni certifikaten e marteses do drejtoheni ne Perfekture per te marr nje vule te njome.Dhe me pas do e apostilosh. | E plotë | Nuk ka |
| 76 | 21.01.2023 | Kërkesë për informacione me logimin ne ealbania | 25.01.2023 | Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk keni aktive asnjë nga të dhënat e regjistrimit(adresë email dhe numër telefoni) për të gjeneruar një pasword të ri duhet të veproni si më poshtë:<br>Hapni një adresë të re email, dhe dërgoni këto të dhëna në adresën:helpdesk@e-albania.al :<br>- foto të kartës ID<br>- emri i nënës<br>- emri i babait<br>- datëlindja e nënës<br>Specifikoni adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | për llogarinë tuaj në portal. | | |
| 77 | 21.01.2023 | Kërkesë për informacion për logimin në ealbania | 25.01.2023 | Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk keni aktive asnjë nga të dhënat e regjistrimit(adresë email dhe numër telefoni) për të gjeneruar një pasword të ri duhet të veproni si më poshtë: Hapni një adresë të re email, dhe dërgoni këto të dhëna në adresën:helpdesk@e-albania.al<br>- foto të kartës ID<br>- emri i nënës<br>- emri i babait<br>- datëlindja e nënës<br>Specifikoni adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. | E plotë | Nuk ka |
| 78 | 26.01.2023 | Kërkesë për informacion për pushtetin vendor | 26.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se ju lutem drejtohuni pushtetit Vendor. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri 19:00. | E plotë | Nuk ka |
| 79 | 25.01.2023 | Kërkesë për informacion për Platformen ne lidhje me nje ankese | 26.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion,ju bëjmë me dije se ankesën tuaj lutem niseni në Platformen e Bashkëqeverisjes , ne linkun e mëposhtëm : ME TY PËR SHQIPËRINË QË DUAM - Platforma e Bashkëqeverisjes (shqiperiaqeduam.al) **Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.** | E plotë | Nuk ka |
| 80 | 20.01.2023 | Kërkesë për informacion për ndryshim vendbanimi | 26.01.2023 | Pershendetje Ne vijim te kerkeses Tuaj per informacion ju bejme me dije se<br>Doni te ndryshoni vendbanimin tuaj?<br>Nëse po atehere duhet te aplikoni nga e-albania : Aplikim për ndryshim/saktësim vendbanimi<br>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14 | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 419<br>Dokumente që dorëzohen nga aplikanti:<br>- Dokumenti që vërteton pronësinë/përdorimin e banesës.<br>Per cdo pyetje dhe paqartësi mund te na shkruani perseri !<br>Faleminderit | | |
| 81 | 22.01.2023 | Kërkesë për informacion për kontributet | 26.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Te gjitha kontributet pas vitit 2012 e ne vazhdim i gjeni ne sherbimin dhe linkun e meposhtemVërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore (pas datës 01.01.2012) https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13908Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | E plotë | Nuk ka |
| 82 | 30.01.2023 | Kërkesë për informacion me shpallljen e martesës | 30.01.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se procedura e shpalljes së martesës dhe lidhjes së martesës bëhen fizikisht në sportelet e gjendjes civile. Fillimisht duhet të kryeni shpalljen e martesës. Procedura për të bërë **shpalljen e martesës mes dy shtetasve shqiptar në Republikën e Shqipërisë** është si më poshtë vijon :Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa.<br>Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë:prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes;certifikatë lindje, me shënimin "për shpallje martese";fotokopje e dokumentit të identifikimit; Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, secili nga bashkëshortët e ardhshëm pajiset me dokumentin certifikatë lindje për | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | lidhje martese. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy dëshmitarë.**Lidhur me pyetjen tuaj** , ju bëjmë me dije se kjo është procedura e vetme ligjore për shpalljen e martesës. Nuk ka mënyrë tjetër.Për cdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanalin informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në te premte ne fashen orare 08.00 – 19.00 | | |
| 83 | 30.01.2023 | Kërkesë për informacion për pension invaliditeti | 30.01.2023 | Përshëndetje ,<br>Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se per te rinovuar pensionin e invaliditetit, pasi jeni rikomisionuar në KMCAP, duhet të aplikoni nga llogaria juaj në e-albania shërbimin, Kërkesë për rishqyrtim përfitimi (pensioni) në linkun e mëposhtëm:<br>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=2304<br>Do T`ju shfaqen opsionet e meposhtme. Perzgjidhni opsionin "Kompensim për personat në ngarkim"<br>Pleqëri<br>Invaliditet<br>Familjar<br>Suplementar<br>Suplementar i parakohshëm<br>Pension i parakohshëm për vjetërsi shërbimi<br>Kompesim i energjisë elektrike (VKM 565, VKM 8)<br>Kompesim për personat në ngarkim<br>Ngarkoni dokumentet në format pdf dhe dërgoni aplikimin.Pasi të dërgoni aplikimin, paraqituni në sportelet e Postës Shqiptare për të dërguar dokumentet origjinalë, duke vendosur mbi zarf numrin e referencës së aplikimit.<br>Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | E plotë | Nuk ka |
| 84 | 30.01.2023 | Kërkesë për info në lidhje me regjistrimin si person fizik | 30.01.2023 | Pershendetje Ne vijim te Kerkeses Tuaj per informacion ju bejme me dije se së pari, ju nuk keni hapur sherbimin qe eshte online, por keni hapur kartela e vjetra informative<br>Kërkesë për legalizim të ndërtimit pa lejehttps://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14542Por megjithate dhe sherbimi qe ofrohet onnline ka disa kohe qe eshte mbyllur, deri ne nje njoftim te dyte nga ASHK nese do hapen me procedurat per legalizim | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 85 | 29.01.2023 | Kërkesë për info për datat e aplikimit të terheqes se dokumentave | 30.01.2023 | PërshëndetjeNë vijim të Kërkesës Tuaj për informacion ju bëjme me dije se që nga data e aplikmit deri në një vit është afati i tërheqjes se dokumentit ID ose pasaportë.Për çdo pyetje dhe paqartësi mund të na kontkatoni përsëri ! Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 86 | 30.01.2023 | Kërkesë për info në lidhje me tërheqjen e vërtetimit të njohjes së diplomës. | 30.01.2023 | Përshendetje të nderuar ,<br>Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Bëra një aplikim gabim tek e-albania:<br>Kujt duhet ti drejtohem per kete problem?<br>Aplikim për njohjen e titujve Akademikë<br>Dhe derdha (me anë të e kushërirës sime Enkelejda Buzi) në bankë faturën 5000 lekë të reja në lidhje me këtë aplikim<br>Aplikimi që duhet të kryej është njëhsimi i arsimit tim të lartë që kam kryer në Itali që është cikël 5 vjeçar.<br>Enkelejda shkoi në bankë dhe i thanë që duhet ti drejtohem dikasterit që i janë dërguar lekët për këtë aplikim që është po QSHA (e njëjtë me aplikimin e ri ). Numri i tel që është publikuar në faqen e -albania nuk është i disponueshëm.<br>Tani dhe aplikimin e ri që duhet të kryej pagesën që do bej që është 20 mijë lekë të reja është serishrt në emër të QSHA . si duhet të revokoj faturën e parë dhe të derdh më pas faturën e dytë? Me fal per shqetesimin dhe ju lutem merreni parasysh kerkesen time per nje pergjigje.<br>Numri im i tel : 0693920823. per te komunikuar sebashku pasi ky eshte numri i kusherires sime Enkelejda Buzi e cila ka bere pagesen ne emrin tim pranë bankes BKT ne Elbasan.<br>Po ju ngarkoj dhe Leternjoftimin tim Ju faleminderit | E deleguar | Nuk ka |
| 87 | 30.01.2023 | Kërkesë për informacion | 30.01.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se ky si subjekt eshte i Drejtorise | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mbi penalitetin nga tatimet | | se tatimeve dhe nese ju keni bere ndryshime te punesimit Tuaj te periudhes jeni raportuar si e paguar ne gjysmen e periudhes dhe gjysmen tjeter brenda muajit ne punen tjeter.Lutem per me shume detaje kontaktoni ne : www.tatime.gov.al ose per me shume asistence na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | | |
| 88 | 30.01.2023 | Kërkesë për informacion për certificate që daton para 2010 | 30.01.2023 | Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se te gjitha certifikatat që datojnë akte (lindje, martese, vdekje, etj) para vitit 2010, nuk mundësohen në e-albania. Për këto certifikata procedohet si më poshtë: Për qytetarët e Tiranës, certifikatat merren tek Bashkia Tiranë. Për rrethinat e Tiranës merren tek Prefektura Tiranë. Për të gjitha bashkitë e komunat e tjera në territorin e Shqipërisë, certifikatat merren pranë Prefekturave të qarqeve respektive.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 89 | 30.01.2023 | Kërkesë për informacion Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë | 30.01.2023 | Përshëndetje,**Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë informacion për çështjen që referoni në kërkesën për informacion, aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin: Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë), ne linkun e meposhtem https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477Fillimisht duhet të hartoni një kërkesë me shkrim, ku të sqaroni arsyet e përdorimit të këtij dokumenti në lidhje me dosjen në proces legalizimi . Kjo kërkesë duhet të firmoset nga ana Juaj dhe të skanohet në formatin PDF . Kërkesa do të ngarkohet në hapin e tretë të aplikimit të shërbimit në e-Albania.Për të përdorur shërbimin,** | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **klikoni “Përdor” në fund të faqes dhe vijoni me plotësimin e formularit elekronik.**Në hapin e dytë, tek të dhënat e pronës, pamvarësisht se Ju nuk keni të dhëna prone, për të orientuar sistemin duhet të vendosni një zonë të saktë kadastrale, ndërsa volumin dhe faqen i vendosni 99. Zona kadastrale duhet të jetë zona që përfshin zonën ku ndodhet objekti Juaj.Klikoni butonin “Dërgo” në faqen e fundit të formularit.Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë ose në poste për të kryer pagesën, si dhe depozitimin me poste të kërkesës që keni bashkëlidhur aplikimit dhe mandatin e pagesës që do të kryeni.**Agjencia Shtetërore e Kadastrës do T`Ju pajisë me informacionin që kërkoni.**Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit | | |
| 90 | 31.01.2023 | Kërkesë për info në lidhje me pajisjen me vërtetim për pagimin e kontributeve për individin | 31.01.2023 | PërshëndetjeNë vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se e përfitoni bonusin e bebit edhe për lindjen e tretëPrindërve u jepet një çek 40,000 lek për fëmijën e parë 80,000 lek për fëmijën e dytë; 120,000 lek për fëmijën e tretë e më tej.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 91 | 30.01.2023 | Kërkesë për informacion mbi QKB | 31.01.2023 | Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se duhet ta beni te faqja e QKB-se ose duhet te beni nje vetedeklarim dhe ta ngrakoni ne aplikim.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | E plotë | Nuk ka |
| 92 | 31.01.2023 | Kërkesë për info për SHPK nga nje shtetas Italian ne territorin e Shqipërisë | 31.01.2023 | Përshëndetje,<br>Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nuk duhet te rregjistrohet ne e-albania per SHPK por duhet te caktoje administratorin me nenshtetesi Shqiptare me ane te nje akti noterial , dhe administratori do te bej rregjistrimin dhe te gjitha hapat perkatese per emer te Tij. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | | |